



---

**R E P U B L I K A   E   S H Q I P È R I S Ë**  
**AKADEMIA E SHKENCAVE**  
**ASAMBLEJA**

---

Nr. 445 prot.

Tiranë, më 31.10.2017

**V e n d i m**

Nr. 19, datë 31 tetor 2017

**Për reformën institucionale të kërkimit shkencor dhe të ardhmen e Akademisë së Shkencave**

**Drejtar:** Asamblesë së Akademisë së Shkencave;  
Sekcionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike në Akademinë e Shkencave;  
Sekcionit të Shkencave Natyrore e Teknike në Akademinë e Shkencave;  
Sektorit të bibliotekës dhe të botimeve shkencore; sektorit të financës; sektorit të personelit.

**Për dijeni:** KRYEMINISTRISË  
Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë;

Mbështetur:

1. Ligjt nr. 9655, datë 11.12.2006, *Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë*, nenet 9 dhe 10;
2. Statutit të Akademisë së Shkencave, nenet 15 dhe 16;
3. Rekomandimeve të *Procesit të Ballkanit Perëndimor - Procesi i Berlinit* (2015-2016, bashkëmyllur);
4. Kodit européen të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor;

### **Konstatojmë se:**

Asambleja e zgjeruar e Akademisë edhe me akademikët mbi 75 vjeç, si dhe me një përfaqësi të “Akademisë së të Rinjve”, u mblohdh mbështetur kërkesës së një grapi akademikësh dhe me aprovimin e Këshillit Ekzekutiv dhe të Kryesisë së saj, referuar nevojës që ka situata aktuale e reformës së kërkimit shkencor në vend, për shqyrtim, analizim, dhënie mendimesh dhe rrugëzgjidhjesh nga anëtarët e saj, si organi më i lartë drejtues, posaçërisht lidhur me ardhmërinë institucionale të Akademisë së Shkencave, pas njoftimeve për mos alokimin e mbështetjes buxhetore për vitin 2018;

Mbledhja pasi verifikoi ligjshmërinë dhe *quorum*-in, mbështetur rendit të ditës (bashkëmbyllur), të bërë me dije nga Sekretari Shkencor, u zhvillua në përbushje të detyrave funksionale të Asamblesë, si organi më i lartë drejtues i Akademisë së Shkencave, e cila shqyrton dhe miraton drejtimet kryesore të veprimtarisë shkencore të Akademisë, vendos për çështje të tjera të rëndësishme me karakter shkencor e organizativ; shqyrton probleme të zhvillimit perspektiv të shkencave në vend dhe u paraqet propozime organeve kompetente.

Në diskutimet e tyre akademikët Apolon Baçe, Artan Fuga, Gudar Beqiraj, Emin Riza, Gjovalin Shkurtaj, Marenglen Verli, Floresha Dado, Beqir Meta, Dhimitër Haxhimihali, Floran Vila, Shaban Sinani, Salvator Bushati dhe prof. asoc. dr. Rigers Bakiu (bashkëkryetar i “Akademisë së të Rinjve”), shprehën kundërshtimin për lajmet për mosalokimin e mbështetjes financiare / buxhetore për Akademinë e Shkencave dhe dhanë propozimet e tyre për hapat e mëtejshme të ecurisë së reformës në tërësi dhe për Akademinë e Shkencave në veçanti (shih materialin e plotë video të mbledhjes).

Mbledhja u zhvillua në kushtet kur Akademia e Shkencave, përmes Asamblesë, Këshillit Ekzekutiv, Kryesisë, seksioneve dhe çdo akademiku, ka shprehur dhe dhënë në vijimësi disavjeçare, angazhimin e plotë dhe ekspertizën për kryerjen e reformës institucionale të kërkimit shkencor në vend dhe si pjesë e saj edhe reformimin e Akademisë së Shkencave; kur nevojitet një dinamikë e re që draftet: 1. *Dokumenti i strategjisë kombëtare të zhvillimit të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe të inovacionit për vitet 2017-2022*; 2. *Dokumenti për politikën e reformimit institucional të kërkimit shkencor, ku Akademia e Shkencave është një subjekt më vete*; dhe 3. *Projekt-ligi i ri për shkencën*, të cilat janë hartuar falë kësaj pune të përbashkët dhe që janë baza e përputhjes së ekspertizës akademike me vendimarrjen qeveritare e më gjërë të përbypullen përmes një procesi të përbashkët.

Mbështetur këtyre propozimeve, Asambleja e ASH-së, në mbledhjen e saj të datës 31 tetor 2017, ora 12.00, në sallën “*Aleks Buda*”,

### **VENDOSI:**

1. Mbajtjen e një konference dhe paraqitjen e një deklarate për shtyp, për informimin e opinionit publik, ditën e enjte, datë 2 nëntor 2017, ora 13.00 në sallën “*Aleks Buda*” në Akademinë e Shkencave. Përbërja e panelit të konferencës për shtyp është si më poshtë:

*Akademik Vasil S. Tole* anëtar i Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë  
*Akademik Salvator Bushati* anëtar i i Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë  
*Akademike Aurela Anastasi,* anëtar i Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë  
*Akademik Artan Fuga,* anëtar i Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë  
*Akademik Apollon Baçe* anëtar i Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë  
*Akademik Beqir Meta* anëtar i Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

2. T'i kërkohet zyrtarisht takim Kryeministrit të Shqipërisë, Shkëlqesisë së Tij Z. Edi Rama, me Asamblenë e zgjeruar të Akademisë së Shkencave.
3. T'i kërkohet zyrtarisht institucionit të Presidentit përgjigje në lidhje me praktikën shkresore të dërguar për zgjedhjen e Kryetarit të ASH-së.
4. Të kërkohen zyrtarisht pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë, dokumentet e hartuara deri më tani nga grupet e punës të ngritura në kuadër të reformës së kërkimit shkencor në vend. Të bëhet zëvendësimi i anëtarit përfaqësues të ASH-së, ish-kryetarit akad. Korkuti, sipas Urdhrit nr. 297, datë 1.6.2016, “*Për ngritjen e grupit të punës për reformimin e sistemit institucional të kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë*”.
5. Komisioni i posaçëm *ad hoc*, i ngritur me Vendimini nr. 18, datë 11 shtator 2017 “*Për krijimin e komisionit të akademikëve (ad hoc) me mandat të plotë përfaqësimi nga asambleja e Akademisë së Shkencave për reformën në kërkimin shkencor dhe atë të Akademisë së Shkencave*”, të përmbylli brenda datës 16 nëntor 2017 propozimin e institucionit lidhur me reformimin e sistemit institucional të kërkimit shkencor në emër të Asamblesë së Akademisë së Shkencave dhe vardin e Akademisë së Shkencave në të, si dhe ta kalojë për aprovim në mbledhjen e radhës së kësaj asambleje. Komisioni të vjelë të gjitha mendimet e akademikëve dhe të konsultohet me gjithë praktikën shkresore të prodhuar nga ky proces ndërinstitucional. Ky dokument i aprovuar nga Asambleja t'i dërgohet zyrtarisht Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Sekretaria e Kryesisë të bëjë menjëherë njoftimin për organizimin e mbledhjeve të këtij komisioni.
6. Ngarkohet specialisti i shërbimit IT për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të Akademisë së Shkencave.
7. Ngarkohet Këshilli Ekzekutiv për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Sekretar Shkencor**

**Vasil S. Tole**

